



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.381/10 prot

Datë 26.03.2025

V E N D I M
Nr. 410/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Mbyllje e çështjes për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor, për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” ShPK për shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ALComm Solutions” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” Mall, me Nr. REF-34492-12-24-2024, me objekt: Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit, me fond limit 12.498.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK, në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK, në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur.

Ankimues: Operatori ekonomik “PC STORE” ShPK, me Nipt L01606034A,
Adresa: Rr. e Dibrës, vila 153, kati 1, Tiranë.

Operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK, me Nipt K22113002I, *Adresa: Rr. “Butrinti” nr.9 , Nj. Adm. Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës.
Adresa: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

Subjekte të interesuara: Operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK, me Nipt K22113002I, *Adresa: Rr. “Butrinti”, nr.9, Nj. Adm. Kashar, Tiranë.*

Operatori ekonomik “ALComm Solutions” ShPK, me Nipt M01427004J, *Adresa: Rr. “Petro Nini Luarasi”, Pallati 8, kati 1, Z kadastrale nr. 8160, Nr. pasurie 3/943-N8, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues, për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave.

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.12.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” Mall, me Nr. REF-34492-12-24-2024, me objekt: Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit, me fond limit 12.498.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit në datën 10.01.2025, dhe më datë 21.01.2025 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

“Adi Professional” SHPK	me ofertë	10.917.800 Lekë		Kualifikuar
“ALComm Solutions” SHPK	“	11.319.300	“	Kualifikuar
“FREDI ELECTRONIC” SHPK	“	12.251.000	“	Skualifikuar
“PC STORE” SHPK	“	12.320.000	“	Kualifikuar

II.3. Më datë **06.02.2025** autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE **Njoftimin paraprak të fituesit** si edhe publikuar në buletin e njoftimeve publike me Nr. 7, datë 10 shkurt 2025.

II.4. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, janë administruar ankesat me numër ankimi elektronik A/2025/5033, datë 07.02.2025 dhe me Nr. 381/2025 Prot., datë 10.02.2025, si edhe ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5032, datë 07.02.2025 dhe me Nr. 381/1/2025 Prot., datë 10.02.2025, nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Adi Professional” ShPK dhe “ALComm Solutions” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.5 Bazuar në nenin 112 pika 4 të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 381/2 prot., datë 11.02.2025, u publikuan pretendimet e ankimuesit mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.6. Njëpërmjet shërbimit postar operatori ekonomik i interesuar “Adi Professional” ShPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave datë 14.02.2025, protokolluar me tonën me Nr.381/3, datë 17.02.2024. Nga informacioni i përcjellë nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të prokurimit Publik me shkresën nr.2141/10 prot., datë 07.03.2025, protokolluar me tonën me nr.381/7 prot., datë 10.03.2025, rezulton se operatori ekonomik i interesuar “Adi Professional” ShPK ka paraqitur Formularin e argumentave pranë autoritetit kontraktor më datë 17.02.2025.

II.7. Me shkresën me nr. 381/4 prot., datë 21.02.2025, Komisioni i kërkoi autoritetit kontraktor informacion mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “PC STORE” ShPK dhe vendimin e KSHA-së.

II.8. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 2141/7 prot., datë 24.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 381/5, datë 25.02.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin Nr. 2141/2 prot., datë 21.02.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke njoftuar vendimin e KSHA-së për pranim të pjesëshëm të ankesës. Referuar Vendimit të KSHA-së, autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” ShPK, në lidhje me pretendimet e ngritura për operatorët ekonomikë “Adi Professional” ShPK dhe “ALComm Solutions” ShPK ofertues në procedurën e prokurimit sipërcituar. Bashkëlidhur shkresës autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP-së kopje të dokumenteve provuese të ofertës së operatorit ekonomik i renditur i pari “Adi Professional” ShPK.

II.9. Me shkresën nr. 381/6 prot., datë 18.02.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkon autoritetit kontraktor informacion, në mënyrë të përmbledhur shkresa si vijon:

[...] Bazuar në nenin 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”, kërkojmë të na informoni për sa më poshtë:

1. A keni njoftuar operatorët ekonomikë të interesuar “ADI PROFESSIONAL” ShPK dhe “ALComm Solutions” ShPK mbi vendimmarrjen e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK?
2. Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimet e vendimit të KSHA-së dërguar operatorëve ekonomikë të interesuar.

Me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duhet të dërgoni pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar, brenda dy ditësh nga marrja e kësaj shkrese.

II.10. Me shkresën nr. 2141/10 prot., datë 07.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 381/7, datë 10.03.2025 me objekt: Informacion nga autoriteti kontraktor në lidhje me kërkesën sipërcituar, Autoriteti kontraktor informon se ka njoftuar OE. Adi Professional ShPK me

shkresën Nr. 2141/6 prot., datë 24.02.2025, (bashkëlidhur kopje e faqes së librit të postës si edhe kopje e e-mailit që mban datën 24.02.2025)

Gjithashtu Autoriteti kontraktor ka përcjellë vendimin e KSHA-së për OE. “ALComm Solutions” ShPK me shkresën Nr. 2141/9 prot., datë 06.03.2025 (bashkëlidhur kopje e-mailit që mban datën 05.03.2025).

II.11. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5096, datë 28.02.2025 dhe me Nr. 603/2025 Prot., date 01.03.2025 e operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” Mall, me Nr. REF-34492-12-24-2024, me objekt: Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit, me fond limit 12.498.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.12. Bazuar në nenin 112 pika 4 të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 603/1 prot., datë 03.03.2025, u publikuan pretendime të ankimuesit mbi vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e Vendimit të KSHA-së mbi pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ankimues “PC STORE” SHPK për operatorin ekonomik “Adi Professional” ShPK si më poshtë vijon:

“Lidhur me pikën e katërt të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “PS STORE” SHPK, i cili ngre pretendime se operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK se nuk ka dorëzuar dokumentet në përputhje me kriterin 2.4.2. të kriterëve të veçanta të kualifikimit në DT,

KSHA Argumenton:

Pas vlerësimit të dokumentacionit ndodhur në SPE njëkohësisht edhe atij fizik të dorëzuar pranë AK-së, konstatohet se OE. Adi Profesional ShPK, për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur:

- 1. Autorizim distributori nga IT Distribution Albania (MUK), i cili autorizon OE Adi Professional ShPK për produktet e DELL Technologies, por IT Distribution Albania (MUK) nuk ka paraqitur kontratë ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit DELL Technologies dhe distributorit IT Distribution Albania (MUK), (të nënshkruar).*
- 2. Autorizim distributori nga Advanced ShPK, i cili autorizon OE Adi Professional ShPK për produktet e sigurisë dhe vëzhgimit të markës Provision ISR, por Advanced ShPK nuk ka paraqitur kontratën ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit Provision ISR dhe distributorit Advanced ShPK (të nënshkruar).*
- 3. Nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi apo Distributori, katalog dhe skedat teknike të prodhuesit për artikujt:*

Kabinë Operatori

Rack 16U

Përsa më sipër gjykojmë se dokumentacioni i paraqitur nga ky operator nuk është në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi, konkretisht VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si edhe VKM nr. 134, datë 7.3.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja për përdorim brenda vendit.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “PC Store” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Adi Professional” ShPK dhe “ALComm Solutions” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.1.1. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 2141/7 prot., datë 24.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 381/5, datë 25.02.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin Nr. 2141/2 prot., datë 21.02.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke njoftuar vendimin e KSHA-së për pranim të pjesshëm të ankesës. Referuar Vendimit të KSHA-së, autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” ShPK, në lidhje me pretendimet e ngritura për operatorët ekonomikë “Adi Professional” ShPK dhe “ALComm Solutions” ShPK ofertues në procedurën e prokurimit sipërcituar. Bashkëlidhur shkresës autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP-së kopje të dokumenteve provuese të ofertës së operatorit ekonomik i renditur i pari “Adi Professional” ShPK. Për këtë fakt, operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK ka paraqitur Formularin e Ankesës në sistemin elektronik, pranë Komisionin e Prokurimit Publik në pëputhje me nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA).

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin*

e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Në rastin konkret nuk rezulton që nga operatori ekonomik “ALComm Solutions” ShPK, të jenë paraqitur argumenta sipas pikës 1 të nenit 113 të LPP. Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 381 prot., datë 10.02.2025, të operatorit ekonomik “PC Store SHPK, sa i përket skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALComm Solutions” ShPK,

Ndërsa lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Adi Professional” SHPK, Komisioni vlerëson se në rastin konkret nuk mund të mbylli çështjen lidhur me këtë pjesë të pranuar nga KSHA, duke qenë se operatori ekonomik i intresur “Adi Professional” SHPK ka paraqitur argumenta, argumenta të cilat janë protokolluar pranë KPP me Nr.381/3, datë 17.02.2024.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PC Store” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adi Professional” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se,

III.2.1.Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e përcaktimieve të bëra në nenin 113 e 114/5 të LPP, e më konkretisht të paraqitjes së argumentave njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike.

III.2.2..Në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar Sistemin e Ankesave Elektronike, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë, paraqitjen e ankesës dhe të argumentave në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit/Entit Kontraktor, në rrugë elektronike. Neni 113 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave.*

Referuar procedurës së prokurimit objekt – ankimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ, Komisioni konstaton, se në datën 07.02.2025 janë administruar ankesat me numër ankimi elektronik A/2025/5033, datë 07.02.2025 e Nr. 381/2025 Prot., datë 10.02.2025, si edhe ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5032, datë 07.02.2025 e Nr. 381/1/2025 Prot., datë 10.02.2025, nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Adi Professional” ShPK dhe “ALComm Solutions” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Nëpërmjet shërbimit postar operatori ekonomik i interesuar “Adi Professional” ShPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave datë 14.02.2025, protokolluar me tonën me Nr.381/3, datë 17.02.2024. Nga informacioni i përcjellë nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të prokurimit Publik me shkresën nr.2141/10 prot., datë 07.03.2025, protokolluar me tonën me nr.381/7 prot., datë 10.03.2025, rezulton se operatori ekonomik i interesuar “Adi Professional” ShPK ka paraqitur Formularin e argumentave pranë autoritetit kontraktor më datë 17.02.2025. Operatori ekonomik i interesuar në datën 14.02.2025 ka dërguar në adresën zyrtare të komisionit të prokurimit Publik një email me përmbajtje si vijon: “[...]Në datën 10.02.2025 në sistemin e ankesave që administrohet nga Komisioni i Prokurimit Publik, janë publikuar 2 (dy) ankesa të llojit “vlerësim”, të depozituara nga operatorit ekonomik “Pc Store” Sh.p.k, përkatësisht ankesa me nr. A/2025/5032, numër protokolli: 381/1/2025, datë protokolli: 2025-02-10 dhe ankesa me nr. A/2025/5033, numër protokolli: 381/2025, datë protokolli 2025-02-10. Gjate gjithë dites sotme stafi ligjor i Adi Professional eshte perpjekur te dergoje argumentat ne cilesine e OE te interesuar, per te kundërshtuar ankesat e

sipercituara nepermjet portalit qeveritar e-albania, por sherbimi perkates ne kete portal nuk funksiononte ne menyre te rregullt, pasi sistemi nuk arrin te identifikoj ankesen nepermjet numrit e ankesës elektronike i cili plotesohet manualisht ne seksonin III.

Duke mosidentifikuar ankesen, sistemi nuk lejon perfundimin e aplikimit dhe dergimin e argumentave elektronikisht ne AK dhe KPP

Ndodhur ne keto kushte , duke mbajtur ne konsiderate qe data 14.02.2025 eshte afati i fundit per depozitimin e argumentave OE "Adi Profesional" dergoi materialinme argumetat nepermjet sherbimit postar (Posta Shqiptare), i cili do te kryej dorezimin e materialit ditën e hene, date 17.02.2025.

Duke qene se argumentat tona nuk jane derguar elektronikisht per shkaqe te pavaruara nga vullneti jone te cituara qarte me larte, si dhe duke mbajtur ne konsiderate qe materiali me argumentat eshte depozituar ne sherbimin postar brenda dates 14.02.2025, OE "Adi Profesional" konsideron se argumentat e tij jane derguar brenda afatit ligjor, dhe si te tilla duhet te merren ne shqyrtim nga KPP dhe KSHA.

Nisur nga problematikat e hasura nga operatorë ekonomik në dorëzimin e argumentave në Sistemin e ankesave elektronike Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 121 prot, datë 14.01.2025, iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me kërkesën për asistencë nëse ka ndodhur problematikë me shërbimin “Argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë autoritetit /entit kontraktordhe Komisionit të prokurimit Publik” për periudhën 06.01.2025 e në vazhdim si dhe marrjen e masave për zgjidhjen e saj. Me shkresën me nr. 147/1 prot., datë 21.03.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 121/1 prot., datë 25.03.2025, Agjencia Kombëtare e shoqërisë së Informacionit ka informuar si vijon: “[...] 1- Nga ndjekësit e kontrates është konstatuar një problematikë që pengonte Operatorët Ekonomikë të përfundonin Argumentin përmes portalit e-Albania. Problemi u adresua menjëherë dhe që prej konfirmimit të zgjidhjes së problematikës, nuk janë raportuar më vështirësi me asnjë nga shërbimet. Kontrolli i kryer për zgjidhjen e problematikës evidentoi se problematika prekte vetëm operatorët që përpiqeshin të hartonin një Argument për një ankesë të bërë nga një operator tjetër ekonomik, ndërsa cikli i procesit ka rezultuar i suksesshëm për Argumentet e hartuara ndaj ankesave vetjake. 2- Sqarojmë se, komunikimi i përmendur në shkresë ndërmjet Operatorit Ekonomik mirëmbajtës të sistemit dhe personave përgjegjës për ndjekjen e kontratës lidhet me testimet periodike të shërbimit për Operatorët Ekonomikë të huaj të paregjistruar në QKB. Këto janë shërbime të reja dhe ende në fazë testimi. 3- Gjithashtu është kryer një testim i ri i shërbimit, i cili ka rezultuar i suksesshëm. Në përfundim të procesit, për Argumentin Test u gjenerua numri i aplikimit C/2025/543”.

Ndodhur në kushtet kur referuar shkresës së dorëzuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me nr. 147/1 prot., datë 21.03.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 121/1 prot., datë 25.03.2025, rezulton se operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK nuk i është mundësuar dorëzimi i argumentave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, pra ky shërbim elektronikisht, sikurse përcaktohet në nenin 113 të LPP operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK ka marrë masa për dorëzimin e argumentave pranë autoritetit kontraktor Bashkisë Durrës dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Procesi i digjitalizimit të ofrimit të shërbimit dhe përcaktimi i detyrimit ligjor për dorëzimin e ankesave dhe argumentave vetëm në rrugë elektronike është një mjet

procedural në funksion të lehtësimit të procedurës së ushtrimit të të drejtës kushtetuese dhe ligjore të ankimit. KPP në ngritjen e sistemit të ankesve elektronike ka bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit ku ka marrë mendim në lidhje me manualët e dorëzimit të sistemit të ankesave elektronike për operatorët ekonomikë miratuar me vendimin nr. 328, datë 06.04.2022 “Për miratimin e manualit të operatorëve ekonomikë për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe dorëzimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike.

Sa më sipër arsyetuar në kushtet kur në datën e dorëzimit të argumentave operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK, referuar kthim përgjigjes së dhënë nga AKSHI, nuk ka patur mundësi ti dorëzojë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pasi sistemi nuk i ka dhënë mundësi operatorit ekonomik ti paraqesë elektromnikishtsi dhe në kushtet ku operatori ekonomik ka përmbushur detyrimin e ligjit të të parashikuar në nenin 113 të tij për paraqitjen e argumentave brenda afateve të parashikuara në të dy institucionet njëherazi sipas mënyrës së vetme të lejuar në atë kohë dhe në përputhje me kushtet formale dhe ato të legjitimitetit *ratione temporis*, operatori ekonomik ka përmbushur detyrimin për paraqitjen e argumentave.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK ngritur në ankesën e tij me nr. 381/2025, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK, për mosplotësim të kriterit 2.4.2.

4. Për listën e mallrave/materialeve të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara. Për materialet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimiti, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara në Specifikimet teknike.

- për pajisjet
- Rack 16U.
 - Kabinë operatori.

III.3.1 Autoriteti Kontraktor me Vendimin Nr. 2141/2 Prot., datë 21.02.2025 të KSHA-së arsyeton se pranon pjesërisht ankesën për pretendimin e sipërcituar si vijon:

“Lidhur me pikën e katërt të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “PS STORE” SHPK, i cili pretendon se operatori ekonomik “ADI PROFESSIONAL” ShPK nuk ka dorëzuar dokumentet në përputhje me kriterin 2.4.2. të kritereve të veçanta të kualifikimit në DT, sqarojmë se:

Pas vlerësimit të dokumentacionit ndodhur në SPE njëkohësisht edhe atij fizik të dorëzuar pranë AK-së, konstatohet se OE. ADI PROFESIONAL ShPK, për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur:

- 1. Autorizim distributori nga IT Distribution Albania (MUK), i cili autorizon OE Adi Professional ShPK për produktet e DELL Technologies, por IT Distribution Albania (MUK) nuk ka paraqitur kontratë ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit DELL Technologies dhe distributorit IT Distribution Albania (MUK), (të nënshkruar).*

2. *Autorizim distributori nga Advanced ShPK, i cili autorizon OE Adi Professional ShPK për produktet e sigurisë dhe vëzhgimit të markës Provision ISR, por Advanced ShPK nuk ka paraqitur kontratën ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit Provision ISR dhe distributorit Advanced ShPK (të nënshkruar).*
3. *Nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi apo Distributori, katalog dhe skedat teknike të prodhuesit për artikujt:*

Kabinë Operatori

Rack 16U

Përsa më sipër gjykojmë se dokumentacioni i paraqitur nga ky operator nuk është në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi, konkretisht VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si edhe VKM nr. 134, datë 7.3.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja për përdorim brenda vendit.”.

Vendosi:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së operatorit ankimues “PC STORE” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur” Mall, me Nr. REF-34492-12-24-2024, me objekt: Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit, me fond limit 12.498.000 Lekë pa TVSH.

III.3.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5096, datë 28.02.2025 dhe me Nr. 603/2025 Prot., date 01.03.2025 e operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” Mall, me Nr. REF-34492-12-24-2024, me objekt: Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit, me fond limit 12.498.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

a) Në gjykimin tonë si operator që cënohem nga vendimmarrja objekt i këtij ankimi, KSHA ka shqyrtuar në themel ankesën e paraqitur nga OE “PC STORE” për procedurën e prokurimit me nr. Ref-34492-12-24-2024, me objekt “Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit”, duke mos mbajtur në konsideratë faktin se ankesa nuk plotëson kërkesat formale të ankimit, të parashikuara nga ligji i fushës si dhe nga kodi i procedurave administrative. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së ankesës rezulton se ankuesi ka vetëm “dyshime të arsyeshme” dhe “bindjen se OE “Adi Professional” nuk përmbush pikat 2.3.2 dhe 2.4.2 të kriterëve të kualifikimit, dhe nuk ka paraqitur asnjë referencë, argument apo provë për të mbështetur bindjen dhe dyshimin e tij. Lidhur me këtë pikë dëshirojmë të sjellim në vëmendje të KPP-se (në vijim referuar si KPP) se mënyra e paraqitjes së një ankimi si dhe rregullat për shqyrtimin e tij gjenden të normuara në K.Pr. Adm dhe ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Konkretisht, K.Pr. Adm. në nenin 82, pika 1, përcakton se “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie

mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej sajë.

Në rastin konkret konstatohet hapazi se “Pc Store” ShPK në cilësinë e ankuesit, nuk ka paraqitur asnjë provë (direkte ose indirekte), indicie nga burime të hapura apo ndonjë argument minimal për të përmbushur “në dukje” barrën e provës dhe për të provuar përsëri “në dukje” pretendimet e ngritura në ankim, por ka paraqitur vetëm aludime të pastra nëpërmjet përdorimit frazave “shprehim dyshime”, “kemi dyshimin e arsyeshme” dhe “kemi bindjen” për të justifikuar kundërshtimin e kualifikimit të OE “Adi Professional”

KSHA nuk duhet të shqyrtonte në themel ankimin e paraqitur nga “PC STORE” për shkak të mosplotësimin të kushteve formale të ankesës (prova dhe argumenta),

b) Lidhur me konstatimet e KSHA-se, sa i takon plotësimin të pikës 2.4.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, respektivisht konstatimit se subjekti “Advanced” sh.p.k nuk ka paraqitur kontratën ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit Provision ISR dhe distributorit Advanced sh.p.k (të nënshkruar) në lidhje me produktet e sigurisë dhe vëzhgimit si dhe IT Distribution Albaniaë (MUK) nuk ka paraqitur kontratën ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit DELL Technologies dhe distributorit IT Distribution Albania (MUK) (te nënshkruar) për produktet e DELL Technologies. Është në kundërshtim të hapur me dokumentacionin e paraqitur si fillim në SPE dhe me pas i dorezuar fizikisht pranë AK-së. IT Distribution Albania (MUK) dhe Advanced Sh.p.k janë subjekte tregtare të cilat duke qenë distributore të markave DELL Technologies dhe Provision ISR janë përzgjedhur nga “Adi Professional” ShPK me qëllim për të garantuar furnizimin me pajisjet e kërkuara nga AK. Për këtë qëllim këto dy subjekte kanë lëshuar nga një autorizim distributori nëpërmjet të cilës garantojnë AK që do të furnizojnë oe. Adi Professional, me mallrat përkatës për të cilët këto subjekte janë të autorizuar nga prodhuesit.

Në këtë procedurë prokurimi Adi professional është në rolin e operatorit ekonomik ofertues ndërkohë që IT Distribution Albania (MUK) dhe Advanced Sh.p.k janë në rolin FURNITOREVE te operatorit ofertues.

Nisur nga këto pozicione që kanë këto subjekte në këtë procedurë e prokurimi, del qartë se dokumentacioni për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit duhet të paraqitet vetëm nga operatori ofertues Adi Profesional dhe jo nga subjektet furnitore IT Distribution Albania (MUK) dhe Advanced Sh.P.K, sikurse shprehet KSHA

Arsyet e skualifikimit: IT Distribution Albania (MUK) nuk ka paraqitur kontratën ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit DELL Technologies dhe distributorit IT Distribution Albania (MUK) (të nënshkruar), 2?????????????????.Advanced Sh.p.k nuk ka paraqitur kontratën ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit Provision ISR dhe distributorit Advanced Sh.p.k (të nënshkruar).

b) Për plotësimin e Pikës 2.4.2, Operatori Ekonomik Adi Professional ka paraqitur Dokumentacionin:

(a) Autorizim Prodhuesi i lëshuar në vitin 2024 nga Dell Technologies Për Grupin e Shoqërive MUK Shqipëri (pjesë e grupit është edhe IT Distribution Albania) për periudhën 3 shkurt 2024-31 janar 2025. Dokumentacioni perkthyer dhe noterizuar.

(b) Autorizim Distributori lëshuar me 9 janar 2025 nga subjekti “IT Distribution Albania” SH.P.K, pjesë e grupit MUK për OE “Adi Profesional” nëpërmjet te cilës garantohet furnizimi për pajisje te markes Dell.

(c) Autorizim prodhuesi date 18 dhjetor 2023 nga Provision ISR për subjektin “Advanced” SH.P.K nëpërmjet të cilit subjekti Advanced Sh.p.k njihet si distributor i autorizuar. Dokumentacioni është përkthyer dhe është noterizuar. (d) Autorizim distributori lëshuar me 9 janar 2025 nga subjekti Advanced Sh.p.k për OE Adi Professionalë i datës 09.01.2025, nëpërmjet të cilit garantohej furnizimi me sistemet e vëzhgimit ku përfshihen edhe kamerat e brendshme dhe të jashtme.

Autorizimet e lëshuara nga prodhuesit Dell Technologies dhe Provision ISR janë certifikata të lëshuara nga këto subjekte private të huaja, nëpërmjet të cilave konfirmohet fakti që IT Distribution Albania Sh.P.K dhe Advanced Sh.P.K janë distributor të autorizuar për produktet respektive.

Duke qënë se këto certifikata janë lëshuar nga subjekte private të huaja, mënyra e hartimit dhe formati i tyre nuk i nënshtrohet ndonjë ndonjë standarti të caktuar ligjor shqiptar apo të huaj në lidhje me elementët që duhet të përmbajnë këto akte private.

Gjithashtu, konkluzioni i KSHA se dokumentacioni i paraqitur nga Adi Professional nuk është në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi, konkretisht VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 134, datë 7.2.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja për përdorim brenda vendit”, nuk është i saktë nga këndvështrimi i kuadrit rregullativ që përmbajnë aktet nënligjore të cituara nga KSHA.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, nuk përmban asnjë normë rregulluese për elementët që duhet të përmbajnë shkresat e dala nga subjektet private vendase apo të huaja apo edhe shkresat zyrtare të organeve publike.

Sa i takon shkresave zyrtare, elementët e detyrueshëm që e bëjnë një dokument të lëshuara nga administrata publike të vlefshëm ose pavlefshëm, burojnë nga “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe nga Vendimet e Këshillit të Lartë të Arkivave që përcaktojnë formën dhe elementë përbërës të një shkrese zyrtare.

Në lidhje me dhe VKM nr. 134, datë 7.2.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja për përdorim brenda vendit”, sqarojmë se ky akt nënligjor përcakton detyrimin për legalizuar dokumentet e autoriteteve të huaja, shtete e të cilave nuk janë pjesë “konventës mbi heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja” të miratuar me 5 tetor 1961. VKM nr. 134 date 7.2.2003 në pikën 4 përcakton se “dokumentet e AUTORITETEVE TË HUAJA, që do të përdoren brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e RSH-se jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme”. Në bazë të Vendimit të këshillit të Ministrave nr. 134 date 7.2.2003 sikurse edhe Konventës mbi heqjen e kërkesës për legalizimin të dokumenteve zyrtare të huaja (Konventa e Hagës) dokumentet që i nënshtrohen legalizimit apo apostilimit janë vetëm dokumenta të AUTORITETEVE TË HUAJA, që nënkupton dokumentat zyrtare publike, ku përfshihen edhe aktet noteriale.

Në përfundimin se shkresat PRIVATE TË LËSHUARA NGA INDIVID APO SUBJEKTE TREGTARE, nuk i nënshtrohen procesit të legalizimit apo apostilimit.

c) NË lidhje qëndrimin e KSHA se “Adi Professional” ShPK nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori, katalog dhe skeda teknike të prodhuesit për artikujt Kabinë operatori dhe Rak 16U vlerësojmë se ky konkluzion është në kundërshtim dokumentacionin e Pr Prokurimit, specififikisht DST-në dhe Sp teknike të materialeve.

AK në pikën 2.4.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ka përcaktuar se dokumentacioni (autorizim prodhuesi/distributori, deklaratë/certifikatë konformiteti skedë/katalog teknik) që lidhet me zerat e preventivit duhet të paraqitet vetëm për materialet kryesore të kërkuara. Nisur nga kërkesa e sipërcituar e AK, operatori ekonomik Adi Professionalë gjatë përgatitjes së ofertës për këtë procedurë ka mbajtur në konsideratë jo thjesht preventivin e mallrave të kërkuara apo disa zera të vecant të tij, të cilat janë konsideruar gabimisht nga KSHA si “mallra kryesorë por edhe dokumentin e hartuar nga AK i cili është ngarkuar në SPE me dokumenti, tabelës që ndodhet në faqen nr. 1, rezulton se projekti që synohet të prokurohet dhe zbatohet nga AK përbëhet nga 3 komponent kryesor, konkretisht

(a) F.V Sistem parkimi me barriera hyrje/dalje.

(b) F.V Sistem+server multiparking.

(c) F.V Sistem monitorimi kamera.

-Komponenti i parë, Sistemi i parkimit OE Adi Profesional DOK prodhuar nga subjekti CAME PARKARE GROUP S.L me qendër në Barcelonë, Spanjë. Elementët kryesor të sistemit të parkimit (i cili në vetvete është një pajisje hardëare) janë **Terminalët e hyrje/daljes dhe pajisjet që shërbejnë për kryerjen e pagesës.**

Në përputhje me parashikimet e pikës 2.4.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit Adi Professional për Sistemin e Parkimit me barriera hyrje/dalje ka paraqitur SPE dhe ka dorëzuar pranë AK dokumentacionin për sistemet e parkimit, te renditur si vijon:

Autorizim prodhuesi të lëshuar më datë 3 shtator 2024 nga CAME PARKARE GROUP S.L për OE Adi Profesional, nëpërmjet të cilit konfirmohet se OE është shpërndarës i produkteve të prodhuara nga CAME.

Deklaratë Konformiteti për terminalin e hyrjes dhe daljes (PKE) e lëshuar nga prodhuesi CAME PARKARE GROUP S.L.

Deklaratë Conformiteti për makinerinë automatike të pagesave (PKE) e lëshuar nga prodhuesi CAME PARKARE GROUP S.L. Dokumentacioni është përkthyer dhe noterizuar.

Skedë teknike/katalog për terminalin e hyrjes dhe daljes (PKE)

Skedë teknike/katalog për makinerinë automatike të pagesave (PKE).

Sa takon zrave **Lexues QR kod/ barkod, Lexues karte (Per makinerite hyrje-dalje), Kamera te jashtme 5 MP high resolution**, sqarojmë se këto zëra/elementë janë pjesë përbërëse dhe të pandashme të terminaleve të hyrjes dhe daljes eshte i vlefshëm edhe për këto zëra për të cilat ankimesi ka ngritur dyshime.

- Komponenti Sistem+server multiparking pjesë e ofertës së OE Adi Profesionalë është prodhuar nga subjekti CAME PARKARE GROUP S.L me qender në Barcelonë, Spanjë (programi/softëri Linc 7) dhe prodhuesi Dell Technologies (server multiparking).

Në përputhje me parashikimet e pikës 2.4.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit operatori Adi Professional për Sistemin dhe Serverin Multiparking ka paraqitur SPE dhe ka dorëzuar pranë AK dokumentacionin si renditur si vijon:

Autorizim prodhuesi i lëshuar në vitin 2024 nga Dell Technologies për grupin e shoqërive MUK Shqipëri për periudhën 3 shkurt 2024-31 janar 2025.

Autorizim Distributori lëshuar më 9 janar 2025 nga subjekti IT Distribution Albania Sh.p.k, kompani e cila është pjesë e grupit MUK për OE Adi Profesional nëpërmjet të cilës garantohet furnizimi për pajisje të markës Dell.

Deklaratë konformitetit për serverin e lëshuar nga prodhuesi DELL.

Skedë teknike e serverit të prodhuar nga DELL.

Autorizim prodhuesi të lëshuar më 3 shtator 2024 nga CAME PARKARE GROUP S.L për OE Adi Profesional, nëpërmjet të cilit konfirmohet se OE është shpërndarës i produkteve të prodhuara nga CAME, në të cilën përfshihet edhe **programi Linc 7**.

Manual operimi, Arkitektura dhe Broshurë prezantimi për programin Linc 7.

Lidhur me programin Linc 7 sqarojm se ky zë duke qënë një softëer kompjuterik nuk pajisjet me deklaratë/certifikate konformiteti nga prodhuesi.

-Sa takon komponentit të fundit Sistem monitorimi kamera pjesë e ofertës së OE Adi Profesionalë është prodhuar nga subjekti Provision ISR me qender në Izrael.

Në përputhje me parashikimet e pikës 2.4.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit Adi Professional **për sistemin monitorimi me kamera** ka paraqitur SPE dhe ka dorzuar në AK dokumentacionin si renditur si vijon:

Autorizim prodhuesi me date 18 dhjetor 2023 nga Provision ISR për subjektin Advanced Sh.P.K nëpërmjet të cilit subjekti Advanced Sh.P.K njihet si distributor i autorizuar.

Autorizim distributori lëshuar me 9 janar 2025 nga subjekti Advanced Sh.P.K për OE Adi Professional i dt 09.01.2025, garantohet furnizimi me sistemet e vëzhgimit ku përfshihen edhe kamerat e brendshme dhe të jashtme.

Certifikatë konformiteti me nr. Serie MOSTCG22072493 lëshuar nga prodhuesi Provision ISR për sistemin e vëzhgimit.

Skede teknike për kamerat e vëzhgimit.

Sa i takon zërave të materialeve Kabinë Operatori dhe Rack 16U, AK nuk ka paraqitur asnjë lloj specifikimi teknik për këto materiale, sikurse nuk ka paraqitur specifikime edhe zërin UPS, Printer termikë, Data internet etj.

Nisur nga ky fakt, por edhe nga pikëpamja teknike e funksionimit të një sistemi parkimi konkludohet së zërat të cilat nuk janë shoqëruar me specifikime teknike, ku përfshihen edhe 2 zerat e konsideruar nga KSHA si materiale kryesore, NUK JANË MATERIALE KRYESORE dhe si rrjedhojë nuk duhet të paraqitet dokumentacioni i përcaktuar në pikën 2.4.2 (fjalë e dytë) e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

III.3.3. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:**

2.4.2. Për listën e mallrave/materialeve të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **autorizim prodhuesi ose distributori**. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet **kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit**, për materialet kryesore të kërkuara. Për materialet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve**, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konformiteti, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

III.3.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.5. Në nenin 40, pika 6, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
 - b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
 - c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti

kontraktor përsa kohë i kanë pranuar ato. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.3.7. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK mbi Vendimmarrjen e KSHA për pranim të pretendimeve të operatorit ekonomik “PC STORE” ShPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar se:

Për arsyen e skualifikimi:

1. *Autorizim distributori nga IT Distribution Albania (MUK), i cili autorizon OE Adi Professional ShPK për produktet e DELL Technologies, por IT Distribution Albania (MUK) nuk ka paraqitur kontratë ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit DELL Technologies dhe distributorit IT Distribution Albania (MUK), (të nënshkruar).*

Komisioni, referuar dokumenteve të ofertës së operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK, paraqitur në SPE edhe pranë Autoritetit kontraktor, konstatoi se:

Dokumentet provuese të ofertës së tij në përbushje të kriterit kualifikues 2.4.2 janë si vijon:

-Autorizim_Distributori_MUK_IT, lëshuar nga *IT Distribution Albania, MUK classics of distribution*, si distributor i Produkteve DELL Technologies, me përmbajtje:

[...]Ne IT Distribution Albania jemi distributor zyrtar I Produkteve Dell Technologies në territorin e Shqipërisë, konfirmojmë se “Adi Professional” ShPK ka marrë ofertë për të aplikuar në tenderin “Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit [...] I përkthyer dhe i noterizuar,

-Dokument, Autorizim_Prodhuesi_DELL. Lëshuar nga DELL Technologies për Kualifikim i Grupit të Kompanive MUK Albania, me përmbajtje:

“Ka përbushur parakushtet e programit dhe kërkesat e biznesit për t’u kualifikuar si Distributor i Autorizuar të Partneritetit DELL Technologies. I përkthyer dhe i noterizuar,

2. *Autorizim distributori nga Advanced ShPK, i cili autorizon OE Adi Professional ShPK për produktet e sigurisë dhe vëzhgimit të markës Provision ISR, por Advanced ShPK nuk ka paraqitur kontratën ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesit Provision ISR dhe distributorit Advanced ShPK (të nënshkruar).*

-Autorizim, Lëshuar nga Shoqëria “ADVANCED” ShPK për OE “Adi Professional” ShPK dt. 09.01.2025, për sistemet e vëzhgimit ku përfshihen edhe kamerat e brendshme dhe të jashtme, Kamera, NVR, menaxhim hyrje të kontrolluara, sëitch dhe **Rack** dhe aksesore shtesë. (dokument i firmosur dhe vulosur).

-Dokument, Autorizim_Prodhuesi_PROVISION_ISR:

Kjo Certifikatë i jepet kompanisë “Advanced” ShPK, për njohje e kualifikim të distributorit të Provision ISR në Shqipëri, me të drejta dhe shitje, suport teknik dhe trajnim për gamën e produkteve Provision ISR, (I përkthyer dhe i noterizuar).

-Autorizim_Prodhuesi_CAME Parkare, Group S.L.U Barcelonë-Spanjë,

Me anë të cilit vërtetohet dhe deklarohet që “Adi Professional” ShPK është shitës i autorizuar për sisteme parkimi dhe servera multiparkime, kontroll hyrje dhe aksesore lidhur me to.

Komisioni nga shqyrtimi i dokumenteve sipërcituar, pjesë e ofertës së operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK, konstatoi se operatori ekonomik me dokumentet sipërcituar ka përmbushur kriterin kualifikues 2.4.2. të DST-së. E konkretisht dokumentet e lëshuara nga DELL Technologies, Provision ISR dhe “CAME Parkare, Group S.L.U, janë Autorizime të prodhuesve për distributorët e tyre në Shqipëri. Në përmbajtje të tyre ka edhe elementë si adresat e tyre, koha e vlefshmërisë së tyre, gjithashtu dokumentet janë të përkthyer dhe të noterizuara, në përputhje me kërkesën e AK-së **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

Akoma më tej Komisioni gjykon, se me qëllim vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të ofertave të paraqitura, autoriteti kontraktor mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit, nuk ka pasqyruar asnjë informacion nëse i ka kërkuar apo jo informacion apo sqarim operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë dokumentacion të paraqitur prej tij, në përputhje me pikën 1, të nenit 92 të LPP. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimes arrin të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.4.2 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimin se

3. *Nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi apo Distributori, katalog dhe skedat teknike të prodhuesit për artikujt:*

Kabinë Operatori

Rack 16U

Referuar dokumentacionit të tenderit si edhe Dokumenteve të paraqitura nga operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK, nga shqyrtimi i tyre Komisioni vëren se operatori ekonomik ankimes me dokumentacionin e paraqitur në lidhje me *Autorizim Prodhuesi apo Distributori për Rack 16U*, ka paraqitur dokumentet:

-Autorizim, Lëshuar nga Shoqëria “ADVANCED” ShPK për OE “Adi Professional” ShPK dt. 09.01.2025, për sistemet e vëzhgimit ku përfshihen edhe kamerat e brendshme dhe të jashtme, Kamera, NVR, menaxhim hyrje të kontrolluara, sëitch dhe **Rack** dhe aksesore shtesë. (dokument i firmosur dhe vulosur)

-Dokument, Autorizim_Prodhuesi_PROVISION_ISR:

Kjo Certifikatë i jepet kompanisë “Advanced” ShPK, për njohje e kualifikim të distributorit të Provision ISR në Shqipëri, me të drejta dhe shitje, suport teknik dhe trajnim për gamën e produkteve Provision ISR, (përkthyer dhe noterizuar).

-Autorizim_Prodhuesi_CAME Parkare, Group S.L.U Barcelonë-Spanjë,

Me anë të cilit vërtetohet dhe deklarohet që “Adi Professional” ShPK është shitës i autorizuar për sisteme parkimi dhe servera multiparkime, **kontroll hyrje dhe aksesore lidhur me to.**

Komisioni gjykon se operatorët ekonomikë janë subjektet e interesuara në një procedurë prokurimi të cilët duhet të përmbushin kërkesat e autoriteti kontraktor për sa kohë ata i kanë pranuar ato. Në një procedurë prokurimi autoriteti kontraktor është përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Është detyrë e njëjësive përkatës të japin specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt prokurimi, ato duhet të jenë të sakta dhe të qarta me qëllim për të ndihmuar operatorët ekonomikë të përpilojnë ofertat e tyre.

Referuar ankesës, Komisioni vëren, se operatori ekonomik ka argumentuar ankesën e tij si vijon: [...] *AK në pikën 2.4.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ka përcaktuar se dokumentacioni (autorizim prodhuesi/distributori, deklaratë/certifikatë konformiteti skedë/katalog teknik) që lidhet me zërat e preventivit, duhet të paraqitet vetëm për materialet kryesore të kërkuara. Nisur nga kërkesa e sipërcituar e AK, operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK gjatë përgatitjes së ofertës për këtë procedurë ka mbajtur në konsideratë jo thjesht preventivin e mallrave të kërkuara apo disa zëra të veçantë të tij, të cilat janë konsideruar gabimisht nga KSHA si “mallra kryesore”, por edhe dokumentin e hartuar nga AK i cili është ngarkuar në SPE me dokumenti, tabelës që ndodhet në faqen nr. 1, rezulton se projekti që synohet të prokurohet dhe zbatohet nga AK përbëhet nga 3 komponent kryesor, konkretisht:*

(a) F.V Sistem parkimi me barriera hyrje/dalje.

(b) F.V Sistem+server multiparking.

(c) F.V Sistem monitorimi kamera.

Kabinë Operatori dhe Rack 16U janë pjesë përbërëse, por edhe AK nuk ka dhënë specifikime teknike për këta dy elemente ... ndaj edhe ne si OE nuk mund të japim skeda teknike për ato. [...] Komisioni nga shqyrtimi i dokumenteve të operatorit ekonomik, Skeda teknike, konkretisht në dokumentin e paraqitur: Skeda _teknike _Po_ES_16250C_2Combo, konstatoi, se në tabelën me elementet përbërëse gjendet edhe zëri **Rack Bracket**, duke vërtetuar se ky zë është pjesë përbërës i Sistemit+server multiparking.

Për sa i përket pretendimeve për artikullin Kabinë Operatori, Komisioni mori në shqyrtim dokumentet e procedurës së prokurimi, e konkretisht në dokumentin Specifikime Teknike për “Materiale për sheshet e parkimeve në qytetin e Durrësit” autoriteti kontraktor nuk ka dhënë specifikime teknike për sa i përket artikullit Kabinë Operatori.

Me të drejtë operatori ekonomik ankimes argumenton pretendimet e tij në lidhje me kërkesat e AK-së, se *Kabinë Operatori dhe Rack 16U janë pjesë përbërëse, por edhe AK nuk ka dhënë specifikime teknike për këta dy elemente ...ndaj edhe ne si OE nuk mund të japim skeda teknike për ato.*

Komisioni gjykon se për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka dhënë specifikime teknike në lidhje me përmasat apo edhe skica ilustruese për artikullin Kabinë operator, nuk mund të kërkojë skedë teknike për atë artikull.

Komisioni në analizë të fakteve dhe argumenteve të palëve gjykon se operatori ekonomik ka mirë argumentuar pretendimet e tij mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit nga KSHA.

Përsa referuar pretendimet e operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK ngritur në ankesën e tij me nr, 381/2025 Prot., mbi skualifikim të operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK, për mosdisponim nga ana e tij të dy punonjës elektrikist, si dhe lidhur me pretendimin se nga ana e operatorit ekonomik “Adi Profesional” SHPK nuk ka respektuar normat detyruese të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar KPP vlerëson të mos i marrë ne shqyrtim,, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, operatori ekonomik ankimues, nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin e kriterëve të sipërpëmenduranga operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK.

III.5.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.5.2. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.5.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/premendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.5.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientë e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kriterëve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.5.6. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.5.7. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK nuk merren në shqyrtim.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “PC STORE” SHPK mbi skualifikim të operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK, për mosplotësim saktë nga ana e tij të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, Komisioni I Prokurimit Publik vëren se operatorit ekonomik Adi Professional SHPK ka dorëzuar në sitemin e prokurimit

publikFormularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit. Nga verifikimi I këtij formulari KPP konstaton se operatori ekonomik ka Adi Professional” SHPK e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pikën 1/ç të Shtojcës 8-të, të dokumentave të tenderit, për dhënien e informacionit të plotë dhe të saktë në Formularin e Vetëdeklarimit, pasi nga ana e tij janë plotësuar saktë të gjitha rubrikat e kërkuara.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK ngritur në ankesën e tij me nr, 381/2025 Prot., mbi skualifikim të operatorit ekonomik “AL Comm Solutions” ShPK, për mosplotësim të kriterit 2.4.2., KPP vlerëson të mos I marrë ne shqyrtim, përderisa nga operatori ekonomik I interesuar nuk janë paraqitur argumenta në kuptim të nenit 113 të LPP, e për rrjedhojë gjendja juridike e tij pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “PC Store” SHPK do të ndryshojë nga e kualifikuar në e skualifikuar duke përmbushur interesin e ankimuesit për skualifikimin e tij.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115 pika 1 dhe 3, 118 dhe 131 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagesës për ankimimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen lidhur me pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC Store” për skualifikimin e operatorit ekonomik “ALComm Solutions” ShPK nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” Mall, me Nr. REF-34492-12-24-2024, me objekt: Furnizim, vendosje pajisjesh për parkimet publike në qytetin e Durrësit, me fond limit 12.498.000 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 10.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së për skualifikim e operatorit ekonomik “ALComm Solutions” ShPK nga procedura e sipërpërmendur e prokurimit.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” për skualifikimin e operatorit ekonomik “Adi Professional” ShPK.
4. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK lidhur me Vendimmarrjen e KSHA-së për skualifikim të ofertës së tij nga procedura e sipërpërmendur e prokurimit

5. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KSHA-së për skualifikim të operatorit ekonomik “Adi Professional” SHPK .
6. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
7. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC STORE” ShPK.
8. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
10. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri